



FKPKK

Federata Kombëtare e
Pyjeve dhe Kullotave
Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org



APPK

Asosacioni i
Pronarëve të Pyjeve
Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Kurora e Gjelbër

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 113, shkurt 2012 Çmimi 20 lekë

PRIVATIZIMI I PYJEVE KËRKON MENDIMIN E TË GJITHËVE

Takim i zgjeruar me stafin akademik të Fakultetit të Inxhinierisë Pyjore në UB, Tiranë

Fjala e ministrit Fatmir Mediu

“Më shumë kritere ndaj firmave shfrytëzuese; shembull për t’u ndjekur: Sllovenia”

Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Fatmir Mediu, zhvilloi një diskutim me stafin akademik të Fakultetit të Inxhinierisë Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në lidhje me iniciativën e shprehur nga kryeministri Berisha për privatizimin e pyjeve dhe administrimin e tyre nga shteti vetëm në masën 10 për qind. Gjatë këtij takimi, ministri Mediu u shpreh për drejtimin kryesor të punës që ka pasur MMPAU, në përafrimin e legjisllacionit, harmonizuar me vendet e BE dhe të përshtatshëm për kushtet e vendit tonë (duke marrë si shembull edhe Slloveninë). Ligji është draftuar dhe, së shpejti, do të hidhet për diskutim me grupet e interesit dhe për transparencë me publikun.

Përmirësimi institucional është një tjetër aktivitet, që synon, jo thjesht ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, por krijimin e një Shërbimi Pyjor të standardeve të vendeve të BE.

Gjatë diskutimeve me stafin akademik të Fakultetit të Inxhinierisë Pyjore, por dhe me grupe interesi e të shoqërisë civile, ministri Mediu theksoi se janë bërë përmirësime të ndjeshme për mirëmenaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve, por mbetet akoma shumë për t’u bërë në këto drejtime:

1. Për vendosjen e kritereve të forta teknike, profesionale e



financiare për zgjedhjen e kompanive të shfrytëzimit, si dhe kontrole të forta për marrjen e masave ligjore, kundrejt përgjegjësve (kompani apo shërbim pyjor);

2. Ka zhvillim të industrisë për prodhimin e materialeve bio-energjetike nga mbeturinat e pyllit (Gramsh, Prezë, Elbasan, Librazhd, Korçë), çka tregon për marrëdhënie e partneritet serioz publik-biznes, por që duhet nxitur më tej;

3. Ka prirje për përmirësime teknologjike, që lidhen me sigurinë e biznesit dhe në këtë vështrim, ministri Mediu u shpreh se reformat e qeverisë synojnë që në një periudhë të shkurtër pylltaria të bëhet sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit, duke harmonizuar:

- Lidhjet e interesave të njerëzve me zhvillimin e qëndrueshëm të pyllit, sidomos të shtresave që varren prej tyre, veçanërisht ato të varfra. Kjo kërkon vazhdimin e reformës për transferimin e pyjeve tek

përdoruesit e fundit. Vendet e ngjashme me ne, lidhur me historikun e zhvillimit të pronësisë mbi tokën, kanë përdorur të drejtën zakonore të përdorimit si mekanizëm shpërndarjeje;

- Dhënia e terreneve të degraduara për ripyllëzime, falas (uzufukt), bazuar në mekanizmat e pagesave për shërbimet në ekosistem, do nxiste interesin për pyllëzimet. Sistemi i pagesave për shërbime në ekosistem (CO₂, energji, biodiversitet, kontroll ndaj erozionit, do jenë parime bazë të projektit të ardhshëm të Bankës Botërore, të cilat do të mbështeten me grante konkurruese.

- Dhënia me koncesion apo partneriteti publik - privat për pyjet e lartë, të pazbritshëm (që kërkojnë investime serioze e nivel teknologjik të lartë), qoftë të Parqeve Kombëtare, mund të ishte një mekanizëm eficient për përfitim ekonomik dhe përmirësim ekologjik.

Gjatë këtij takimi, stafi akademik i Fakultetit të Pyjeve, si dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit, u shprehën se një iniciativë e tillë, parashikohet të jetë mjaft efikase, duke sjellë një marrëdhënie akoma më të ngushtë mes privatit dhe pyjeve, të cilët në çastin që do ta shohin atë si pronë të tyre, do të tregojnë akoma më shumë kujdes për mirëmenaxhimin e sipërfaqeve në shfrytëzim. Në këtë vështrim, pedagogët e Fakultetit të Inxhinierisë Pyjore u shprehën se do të shikojnë mundësinë e ndryshimit të kurrikulave akademike, në mënyrë që një iniciativë e tillë të orientohet që në bankat e shkollës, me të gjitha prioritetet dhe veçoritë e saj.

Fjala e Prof. Dr. Vath Tabaku

Takimin e çeli Prof. Dr. Vath Tabaku, dekan i Fakultetit të Shkencave Pyjore, i cili falënderoi te pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe vlerësoi kontributin e ministrit Mediu për t’i dhënë Fakultetit një vend të rëndësishëm në hartimin e strategjive për zhvillimin e pylltarisë në vendin tonë. Është hera e parë që një takim i tillë zhvillohet në këtë Fakultet, saktësoi ai. Nisur nga kjo, stafi akademik e mësimit i këtij Fakulteti, do të jetë kurdoherë i gatshëm të bashkëpunojë pa asnjë rezervë, me interesin e vetëm të kontribuojë për t’u dhënë zgjidhje problemeve të shumta të pylltarisë sonë. Po ashtu, do të mbështesim fuqishëm, me potencialin tonë akademik, përpjekjet dhe luftën që bën qeveria për zbutjen e varfërisë në zonat rurale, të cilat zënë gjysmën e territorit të vendit, që mbulohet nga pyjet e kullotat dhe jeta e banorëve të këtyre zonave varet pothuaj tërësisht nga burimet pyjore.

Vijon në fq. 7



Bashkëpunim i frytshëm i Pronarëve Privatë të Pyjeve të Kosovës

nga BASHKIM GASHI, kryetar i AKPPP, Kosovë

Fq. 2

Seminar konsultues, që i hap rrugë një projekti të ri

ALBORA KACANI - FKPKK, Tiranë

Fq. 4



Pylli ndërmjet tenderit dhe kujdestarit real shekullor ...

Të gjithë pylltarët kur ndërmerren reforma të mëdha shpesh ndjehen të shqetësuar se ndoshta ndryshimi i pronësisë dhe të drejtave të përdorimit do të

ndikojnë në përkeqësimin e pyjeve e kullotave. Të njëjtin shqetësim kishim edhe ne, thotë kryetari i Federatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Kombëtare, kur fermerët dhe

shoqatat së bashku me komunat, thoshin se pyjet e kullotat duhet të jenë në pronësi të tyre dhe të fermerëve tradicionalë, sepse mbrohen më mirë dhe krijojnë më shumë të

ardhura. Për të parë këtë, shton ai, nga viti 2007-2009 realizuam takime në mbi 200 komuna e 6700 fshatra, ku kam marrë pjesë edhe vetë në mëse

Vijon në fq. 5

Bashkëpunim i frytshëm i Pronarëve Privatë të Pyjeve të Kosovës

Gjatë vitit 2011
BASHKIM GASHI - kryetar i AKPPP, Kosovë


Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Privatë të Kosovës, në bashkëpunim me Organizatën Holandeze për Zhvillim, SNV, në fund të dhjetorit të kaluar organizuan një takim pune me kryetarët e shoqatave lokale të themeluara në rajonet ku vepron SNV, si dhe me anëtarët e kryesisë së AKPPP. Në takim u paraqit raporti i punës vjetore nga shoqatat dhe AKPPP, me përshkrim të aktiviteteve nga fillimi i procesit të organizimit në shoqata komunale, rezultatet, si dhe planit për të ardhmen.

SNV, që nga fillimi i zbatimit të projektit në Kosovë, ka bashkëpunuar me AKPPP, me synim mbrojtjen e interesave të pronarëve privatë dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të pyjeve. Shumë çështje të rëndësishme lidhur me pyjet kanë nevojë të qartësohen e posaçërisht për sektorin privat, siç është çështja e pronës, përgjegjësitë e pronarëve privatë për menaxhim të pyllit, procedurat për menaxhim të pyjeve dhe çështje të tjera shumë të rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori. Kështu, nga takimet e ndryshme, me pronarët privatë të tre rajoneve ku vepron SNV, ka rezultuar edhe vendimi për organizimin e pronarëve në shoqata komunale dhe regjistrimi i tyre. Prandaj, nga dhjetori i vitit 2009 deri në dhjetor të 2011-s në nivel komune në të tre rajonet janë formuar 16 shoqata, të cilat përfaqësojnë interesat e pronarëve privatë të pyjeve të komunave përkatëse. Të gjitha shoqatat kanë krijuar struktura organizative, janë mbështetur për hapje zyra dhe përfaqësimi i tyre është pranuar nga sektori i pyjeve. Tani roli i këtyre shoqatave është bërë i dukshëm e i pranueshëm. Kështu, shoqatat me në krye AKPPP, ishin pjese e procesit për hartimin e ligjit të ri dhe janë përfaqësuar në grupin e komisionit parlamentar për hartimin e ligjit të ri të pyjeve në Kosovë. Shoqatat janë zgjeruar edhe me krijimin e rrjetit rajonal ku ata adresojnë çështjet dhe ndajnë përvojat për praktikën e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, përfshirë edhe pylltarinë në zhvillimin rural.

Objektivat e këtij takimi përmblyllës të vitit 2011 ishin reflektim për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me të gjithë përfaqësuesit e shoqatave dhe aktorë të tjerë për zhvillimin e sektorit të pylltarisë dhe rolin e projektit SNV – Sida, që të bashkohen kapacitetet njerëzore për të sjellë diçka të qëndrueshme. Duke parë interesimin e pronarëve dhe rezultatet e arritura, Asociacioni kombëtar po studion mundësinë e zgjerimit të shoqatave dhe bashkëpunimit të mëtutjeshëm mes SNV-së dhe AKPPP e shoqatave lokale.

Raporti vjetor i AKPPP-se

Raportin vjetor për AKPPP e prezantoi kryetari Bashkim Gashi. Sipas tij AKPPP është organizmi kryesor, që përfaqëson e adreson interesat e pronarëve privatë në mbarë Kosovën. Udhëtimin e nisur që nga viti 2005 AKPPP e zgjeroi edhe me fuqizimin organizativ dhe



organizimin e shoqatave të pronarëve të pyjeve në nivel komunal. Për AKPPP ky vit është karakterizuar me aktivitete, dhënie të shërbimeve, përfaqësim në nivel lokal, lobim për pylltarinë si dhe krijim të rrjetit rajonal. AKPPP, në bashkëpunim me shoqatat lokale, kanë organizuar disa takime konsultuese për rishikimin e statutit dhe përgatitjen e Kuvendit të parë. Kuvendi u organizua me përfaqësim të të gjitha shoqatave dhe aktorëve tjerë, si: përfaqësues të MBPZHR, Grupi parlamentar nga Kuvendi i Kosovës, APK, SIDA, SNV dhe partnerë rajonalë.

AKPPP tani ka një strukturë të re dhe bordin e zgjedhur nga 10 shoqatat që ishin të themeluara në nivel komunal. Për fuqizimin organizativ të strukturës së re të AKPPP është mbajtur një trajnim për lider dhe komunikim. Trajnimi

ka qenë shumë i mirë për zhvillimin e përgjegjësisë dhe funksionimin e Asociacionit në strukturën e re.

AKPPP, në bashkëpunim me shoqatat lokale, është duke lobuar në kuadër të përpilimit të ligjit të ri të pylltarisë. Ata insistojnë që procedurat ligjore të thjeshtohen në lidhje me prerjet në pyjet private dhe për mbështetje në përgatitjen e planeve të thjeshta menaxhuese, si dhe të përfshihet mbjellja e drurëve pyjorë dhe përmirësimi i pyjeve të degraduar në grante bujqësore e skema të tjera për grante. Gjatë vitit 2011 AKPPP, së bashku me shoqatat lokale, kanë kontribuar në dhënie të rekomandimeve ligjore për favorizimin e pronarëve në ligjin e ri të pyjeve. Kështu, ata kanë organizuar takime konsultuese si ai në Pejë me shoqatat e rajonit, ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të FKPKK të Shqipërisë. Nga ky takim pronarët dolën me rekomandime të përcjella edhe me pyetësorë të shpërndarë tek pronarët. Rekomandimet e dala nga takimet konsultuese me pronarët, i janë dërguar edhe Ministrisë dhe aktorëve kyç për hartimin e ligjit të ri të pyjeve. AKPPP, ka pas takime

Rajonale me struktura organizative të përfaqësuar nga tri rajonet me katër palët e involvuara si AKPPP - Kosove, FKPKK - Shqipëri, APPP - Maqedoni dhe SNV.

Viti Ndërkombëtar i Pyjeve

Viti 2011 ka qenë Vit Ndërkombëtar i Pyjeve, i shpallur nga Kombet e Bashkuara dhe është shënuar nga Shoqata Mali në bashkëpunim me shoqatën Gjeravica, Finch, si dhe APPP, duke vazhduar realizimin e projektit "Pylli im jeta jonë" mbështetur nga USAID e SNV. Aktiviteti për këtë ditë u organizua në fshatin Vraniq të Suharekës, me praninë dhe prezantimet e nxënësve të tri shkollave të përfshira, si dhe APK, SNV, USAID. Në kuadër të kësaj, AKPPP ka qenë pjesë e disa aktiviteteve, të cilat janë përmblyllur me takimin e përbashkët me APK, USAID, SNV, Shoqatat Mali, Gjeravica e Finch dhe nxënës nga tri shkollat fillore të involvuar në këtë aktivitet.

Në kuadër të bashkëpunimit me Federatën e Shqipërisë, është nënshkruar një marrëveshje për botimin e gazetës mujore për pyjet

"Kurora e Gjelbër", gazete, që duke filluar nga numri 111 i saj ka staf të ri botues dhe do t'u shërbeje të dy organizatave tona, të Shqipërisë e Kosovës.

Faqja zyrtare në Internet

AKPPP këtë vit ka krijuar edhe webfaqen www.akppp.org përmes së cilës të gjitha shoqatat dhe të interesuar të tjerë do të kenë



mundësinë të njihen me aktivitetet e AKPPP dhe ngjarje të tjera në lidhje me sektorin e pyjeve. Webfaqja u është prezantuar shoqatave dhe është kërkuar nga to që ta rifreskojnë me sa më shumë informacion për shoqatat dhe aktivitetet e tyre.

Kohët e fundit edhe ligji i ri për pyjet po diskutohet nga AKPPP, e cila, në takimin përmblyllës të vitit të kaluar ka kërkuar nga shoqatat që të japin mendimet e tyre, që pas kësaj të kemi një ligj cilësor, të kuptueshëm e zbatueshëm.

Lutja e pyjeve ...


- Mos me dëmtoni, më ruani për fëmijët tuaj -
nga **Ardita DINAJ**

Njerëz, kur pranë meje ecni, mos më dëmtoni me papjekuri.
Unë jam ngruhtësia e shtëpisë suaj, vatra e netëve të ftohta të dimrit, hija miqësore dhe mburoja nga të nxehtit e diellit përvëlues.

Unë jam druri i djepit tuaj, çatia e shtëpisë suaj, dërrasa e tryezës suaj, shtrati ku flini ... dhe pushimorja juaj e përtjetshme.

Unë jam ajri që thithni, roja e burimit ku pini, thëngjilli i bukës suaj.
Unë jam jeta juaj, shëndeti, fuqia dhe shpirti, i cili të pushton me bukuri e dashuri. Jam kalendari i pranverave tuaja të zgjuara, flladit veror, vjeshtës frutore dhe dimrit, që ka bukurinë e vet.

Njerëz, dëgjojeni lutjen time, mos më shkëlqeni pa nevojë, mos më digjni me pakujdesi, mos më prisni pakuptim dhe mos me lëndoni pa arsye.



Në përgjigje të ftesës së FKPCK për të marrë pjesë në debat e kontribuar në hartimin e një Ligji sa më jetëgjatë për pyjet, vazhdojnë të vijnë mendime e propozime, disa prej të cilave po i sjellim këtë numër të Gazetës ...

XHELIL META

Unë jam për privatizimin e pyjeve sipas përdorimit tradicional, sepse pronarë të vërtetë të siperfaqeve pyjore ka pak. Por, mendoj se problemet që do të hasen gjatë rrugës do të jenë të shumta e do të kërkojnë kohë të gjatë për t'u zgjidhur. Prandaj, them se ligji i ri lypset të saktësojë mjaft gjëra, që procesi i privatizimit të kryhet me sukses e në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve e kullotave. Sipas meje, disa nga problemet që do të hasen, janë:

A. Legjislacioni jo i qartë:

a) Detyrimet që kanë pronarët e rinj ndaj komunës;

b) Menaxhimi i këtyre pyjeve në cilat metoda do të bazohet, silvikultura që njihet e përdoret tek ne shkon më shumë për pyjet e lartë. Prandaj, lind nevoja të përgatiten manuale të përshtatshme për pyjet privatë, pa ndryshuar qëllimin themelor të silvikulturës.

c. Në menaxhimin e këtyre sipërfaqeve nuk ka vetëm pyll, po edhe bimë mjekësore, për vjeljen e të cilave sot paguhet një taksë në komunë. Po në të ardhmen, kur shpenzimet do t'i këtë pronari i pyllit? Pastaj, edhe me faunën ndodh e njëjta gjë, ndoshta edhe më e ndërlikuar ...

d) Nëse në një pyll privat ka ose do të kalojnë linja tensioni elektrik, rrugë, etj., si do të veprohet, për të mos u bërë burim konflikti me pasojat për të ardhmen.

e) Pyjet që për një arsye ose tjetër, dalin pa pronar e i mbeten komunës, në baze të planeve të mbarështimit kanë nevojë për ndërhyrje. Deri sot ka pasur vetëm përplasje midis komunës e Shërbimit Pyjor, po pastaj? Po ashtu, me ligjin ekzistues komunës nuk i lihet hapësirë që prodhimet e këtyre sipërfaqeve të dalin në tregun e lirë, po të shiten brenda komunës dhe, në këtë rast, të ardhurat do të jenë të pakta e, për rrjedhojë, edhe investimet në pyje do të jenë të pakta. Prandaj edhe kjo duhet paraparë në ligjin e ri.

Por, në vazhdim të këtyre problemeve, që i takon të zgjidhen me ligjin e ri, sipas meje ka edhe probleme teknike, të cilat kërkojnë kohë për t'u bërë.

B. Ka probleme me saktësinë e hartave të planeve komunalë të mbarështimit:

a) Hartat nuk janë të sakta si figura gjeometrike dhe besoj se ky defekt ka shtrirje të gjerë, sepse mesa di unë është një burim që i ka bërë dhe printimi ka shfaqur pasaktësi (rrjeti nuk është 100x100, por 92x92);

b) Ka mbivendosje të siperfaqeve, ndoshta në masë jo të madhe, por probleme ka;

c) Ka sipërfaqe që kanë mbetur jashtë territorit të komunës dhe janë në komunat fqinje apo edhe në komuna të rretheve fqinje.

C. Problemet financiare, që dalin në piken B, nga kush do të mbuloohen?

Ndoshta mund të ketë edhe probleme të tjera, por unë nxora ato që i mendova si pengesë dhe kërkojnë zgjidhje që procesi i privatizimit të

ZEF KREPI

kryetar i Federatës së Pyjeve e Kullotave Komunale, Lezhë

Në Qarkun e Lezhës ka mbi tre vjet që diskutohet për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave komunale në hipoteka. Komunitat ankohen se nuk kanë të ardhura për t'i regjistruar dhe shteti me VKM e hoqi tarifën e regjistrimit. Mbasi u hoq kjo tarifë mbeti një pengesë tjetër e madhe, hartografimi dhe përgatitja e dokumentacionit, që hipotekat kërkojnë për të bërë regjistrimin. Dhe, fakt është që në gjithë qarkun asnjë komunë s'e ka bërë regjistrimin për shkak të kësaj tarife, që kushton shumë. Vetëm komuna e Balldrenit psh, për përgatitjen e dokumenteve për hipotekim i pagoi një firmë private 500 lekë për ha dhe hipotekoi 1200 ha pyje e kullota, që kushtuan 600 000 lekë, po për shkak të koston s'është të përgatitjes së dokumenteve për hipotekim kësaj komune i mbeten pa hipotekuar 2000 ha. Firma private për këtë sipërfaqe prej 1200 ha e ka bërë hipotekimin me harta të shkallës 1 : 25 000 dhe në shumë parcela ka ndërruar destinacionin nga pyll në kullotë dhe, të themi realitetin, ka mjaft të meta në përpilimin e dokumentacionit. Po, po të marrim komuna që kanë mbi 7 apo 8000 ha pyje e kullota; atyre u takon të paguajnë 3 apo 4 milionë lekë, është vërtetë barrë shumë e rëndë për pjesën më të madhe të komunave.

Shoqatat dhe Federata e Pyjeve e qarkut të Lezhës mendojnë se regjistrimi i pyjeve dhe kullotave komunale duhet të behet me harta të shkallës 1:25 000 e sipas parcelave të planeve të mbarështimit dhe të regjistruhen në hipoteka vetëm një herë. Komuna të regjistrojë ato sipërfaqe që kërkon të mbajë në pronësi, pasi të ketë rënë dakord me komunitetin, pastaj, privatët të regjistrojnë pronat e tyre, pyje e kullota, duke përgatitur gjithë dokumentacionin, siç është bërë për tokën bujqësore. Jemi të bindur se regjistrimi i pyjeve e kullotave komunale në hipoteka nga komuna e pastaj përsëri nga pronari është një veprim apo shpenzim i dyfishtë e i panevojshëm. Pra, të gjitha këto të pasqyrohen në ligjin e ri, pasi pastaj do të vuajmë si me token bujqësore. Të mos ndodhë si me ata që morën tokën e ish-NB-ve në përdorim, që vazhdojnë të vuajnë për kthimin e saj në pronësi, plus gjobat që marrin për vonesat e hipotekimit.

dalë me sukses. Mendoj se është për t'u lavdëruar puna e bërë deri tani nga Federatat Rajonale dhe ajo Kombëtare e Pyjeve Komunale, që është bërë deri sot, gjë që do të ndihmojë privatizimin e pyjeve dhe kullotave. E rëndësishme është që të miratohet një ligj sa më i studiuar e afat gjatë e jo të ndodhë si me ligjin për privatizimin e tokës bujqësore, që edhe sot pas dy dekadash vazhdon të diskutohet ...

Komente, mendime e propozime për Ligjin e ri të pyjeve

Dipl. Inxh. ZEF IMERAJ

Kufijtë dhe dokumentacioni ligjor në përdorimin e pyllit

Në strategjinë e miratuar për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri një kapitull i kushtohet përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes se tij krahas ecures së reformave në përgjithësi dhe privatizimit në veçanti. Nisur nga kjo dhe nga e drejta për njohjen e pronës dhe privatizimin e pronës publike, po përpilohet një disa mendime në kuadrin e ftesës për debat publik, para përgatitjes se ligjit të ri për pyjet. Të gjithë jemi dëshmitarë të një realiteti të ri në menaxhimin e burimeve pyjore, falë edhe Projektit të BB e donatorëve të tjerë. Jemi para faktit që sipërfaqe të tëra me pyje e kullota kanë kaluar në përdorim të komunave, fshatrave, fiseve e familjeve. Ky proces ka kaluar nëpër një rrugë të gjatë e të vështirë por tashmë gjendja e këtyre siperfaqeve ka ndryshuar. Në shumë sipërfaqe të zhveshura ka filluar të riinstalohet bimësia pyjore, në sipërfaqet pyjore të degraduara ka filluar ringritja nga punimet e kryera nga përdoruesit.

Në këtë proces u zbatua një filozofi e bazuar në parime tashmë të njohura:

- Pylltaria komunale ka në qendër të saj njerëzit, pastaj drurët.

- Pyjet mbarështohen nga vendasit dhe jo nga jashtë.

- Mbarështimi bazohet më tepër në marrëdhëniet me pyllin se sa në aktivitetin që ushtrohet në pyll.

Gjatë zbatimit të procesit të kalimit të pyjeve në përdorim kanë ndodhur disa dukuri, që shpesh kanë zëvendësuar dispozitat ligjore. Nga historia e pronës tek ne është mësuar se në ato zona

ku pushtet i "sundimtarit", pra i pushtetmbajtësit, nuk ka pasur efektin e duhur apo nuk ka vepruar fare, marrëdhëniet në mes të pronës e pronarit janë vendosur në mënyrë spontane, metoda këto të mishëruara në kanune. Ky mekanizëm është ruajtur deri në ditët tona pothuaj në të gjitha zonat. Kjo mënyrë raporti marrëdhëniesh ka pasur rezultatet e veta deri në mbarim të luftës se dytë botërore, kur çdo marrëdhënie pronësie u zëvendësua me kontrollin e shtetit mbi çdo gjë. Por, kjo "lindi" përsëri pas afro 50 vjetësh, kur pyjet e kullotat filluan të jepen në përdorim. Në komunën Kolsh të Lezhës psh, ndarja e kufijve u bë nga vetë komisioni i fshatit, që pothuaj ruante të njëjtën përmbajtje si para 5 apo 6 brezave por veçse me kulturë qytetare më të lartë. Pra, u ndanë kufijtë në mes të fshatrave e pastaj në mes të komunave. Veçse vlen të thuhet se përveç ngjashmërisë, metoda e zbatuar ndryshon në të gjitha aspektet, pasi tani jetojmë në kohe moderne dhe në një komunitet qytetëruar dhe procesi i tanishëm u bë më i organizuar e me teknologji të studiuar mirë.

I tërë ky proces, që u quajt "kalim i pyjeve e kullotave në pronësi ...", për mendimin tim kaloi e pothuaj "u vjetrua" shpejt. Prandaj, unë mendoj se tashmë ka ardhur koha të hartohen politika social – ekonomike për privatizimin e pyjeve në vendin tonë. Them kështu, pasi nga përvoja del se nuk do rrimë gjatë e të diskutojmë "Pse në vendin tonë burimet pyjore po vijnë duke u shkatërruar dhe mjedisi pyjor e ai në përgjithësi po rrënohen". Privatizimi është proces i pashmangshëm

në shoqëritë ku ne përpiqemi të hyjmë dhe, si i tillë, është pa kthim. Por, ndërsa në sektorët e tjerë kjo filozofi po zë vend më lehtë, në pyje puna ndryshon, kur faktet tregojnë se këto dy dekada pyjet, si pasuri pa pronar konkret, po vetëm me përdorues dëmtohet e rrënohet pandërprerë.

E, që gjendja të ndryshojë për mirë, mendoj se puna duhet të fillojë që nga legjislacioni. Dhe, pas miratimit të ligjit të ri, mendoj se mbështetur në të gjithçka do të zgjidhet sipas radhës e rëndësisë.

♦Ndryshime do të reflektohen në organizimin e piramidës drejtuese të sektorit të pyjeve, si kudo në vendet e zhvilluara.

♦Ndryshime do të reflektohen në organizimin e funksionimit e institucioneve kërkimore, ku do të "përplasen" për shërbimet që u nevojiten, edhe pronarët privatë.

♦Ndryshime reflektohen në metodën e punës së DSHP-ve dhe organizimin e tyre në baze rajonesh më të mëdha.

♦Ndryshime do të reflektohen në organizimin e strukturave të specializuara jopublike dhe të shoqërisë civile, duke hapur vende të reja pune, ku bën pjesë edhe FKPCK, e cila kontribuon në sensibilizimin e ndërgjegjësimin e komuniteteve për thellimin dhe zhvillimin e reformave në mbarështimin e qëndrueshëm të pasurisë pyjore.

♦Ndryshime do të reflektohen në vet mënyrën e organizimit të policisë pyjore, duke zëvendësuar atë me rojtarin e pyllit rrogëtar dhe me rojtarin e pyllit pronar ...

Gjashtë muaj më parë, në çastet kur pjesëtarët e familjes, të afërmit, miqtë e kolegët e shumë me lotë në sy po përcillnin inxh. Kozma Kocanin (Maqon) për në banesën e fundit, një prej tyre, ekonomisti-gazetar Muhamet Derri, hodhi në letër disa vargje, ashtu si i erdhën, siç e ndiente. Katër strofa janë, po kur i lexon, të duket sikur ke lexuar një libër për Maqon. Këto vargje dhe fotoja e ruajtur nga kolegu i tij Gj. Fierza, na i sjellin Maqon para syve "një portret të bukur e njerëzor", të dashur e të qeshur. Në kuadër të 16 shkurtit, "Ditës së Inxhinierit të Pyjeve dhe gjashtëmujorit të ndarjes nga jeta, po e sjellim edhe një herë Maqon në faqet e Gazetës "Kurora e Gjelbër", si një nga bashkëpunëtorët e saj.

nga Muhamet Derri

KOZMAIT

I shenjtë në emër dhe mendim,

Jetën në mes kush ta preu?

Dhe vetë Zoti bëri krim,

Kur nga gjiri ynë të rrëmbeu.

I deshe pyjet, malet dhe burimet,

Siç na deshe, të deshëm ne dhe fëmijët.

Më s'do shohësh të zogjve fluturimet,

S'do kemi ne njeriun që kurrë s'u mërzit.

Merri, vëlla e prind, këto vargje si kujtim,

Na le portretin tënd të bukur, njerëzor.

Njeriu i mirë nuk tretet në harrim,

Për njeriun e mirë do të ketë përherë kuror.

Këto vargje pikuan nga sytë që lotonin,

Kur të përcollëm në botën e amshuar.

Njëri - tjetrin s'dinim si ta ngushëllonim,

Kur ti na ike, papritur, pakujtuar.

Shishtufinë 4 gusht 2011



Seminar konsultues, që i hap rrugë një projekti të ri

ALBORA KACANI
Federata Kombëtare e Pyjeve dhe
Kullotave Komunale, Tiranë



Me 16 shkurt 2012 në mjediset e Restorant "Natyra", Skuraj të Komunës Ulëz, u zhvillua seminari konsultativ me temë: "Studimi dhe analizat e financimeve inovative për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në Ballkanin Jugperëndimor". Morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Banka Botërore, Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore, Organizata Holandeze për Zhvillim, përfaqësues nga shërbimi këshillimor në pyje, nga komunitet Suç, Ulëz e Baz, nga DSHP E Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, punonjës pranë hidrocentralit të Ulëzës, kryetarët e Shoqatave të Përdorimit të Pyjeve Ulëz, Baz e Suç.

Z. Alister Anton, përfaqësues i SNV-se, Shqipëri, ndërmyet të tjerash, tha: Qëllimi i SNV është të punojë me komunitetet, Që të përmirësojnë burimet natyrore dhe të shtojnë të ardhurat e tyre. Prandaj, është e rëndësishme që të gjejmë zgjidhjet si të përmirësohen skemat nxitëse. Ky projekt, i financuar nga PROFOR, BB, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera e i adresuar SNV-së e partnerëve të tjerë, ndihmon në gjetjen e metodave më të mira për studimin dhe analizat financiare të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Qëllimi kryesor i tij është të gjenden skema të reja financimi, për të mbështetur njerëzit që jetojnë afër këtyre baseneve apo në rrjedhën e tyre dhe të përmirësojnë menaxhimin e burimeve natyrore. Në Shqipëri ka filluar një skemë

e tille për pagesat për shërbimet mjedisore përsa i përket sekuestrimit të karbonit, një projekt i mbështetur nga Banka Botërore.

Z. Admir Seci, përfaqësues e MMPAU, pasi falënderoi të gjithë donatorët e veçanërisht BB dhe SNV, për kontributin e dhënë ndër vite për zhvillimin e pyjeve në Shqipëri, nënvizoi se qeveria jonë e ka vlerësuar gjithmonë menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ka marrë hapa të rëndësishëm për transferimin e tyre pranë NJQV, me synim kalimin e tyre pranë përdoruesve të këtyre pyjeve e kullotave. Në kuadër të Proje-



ktit të Dytë të Zhvillimit të Burimeve Natyrore, tha ai, janë realizuar një sërë projektesh dhe angazhimi i NJQV-ve e i komunitetit ka qenë i dukshëm. Me mbështetje të BB dhe donatorëve të tjerë, pritet që se shpejti të implementohet një projekt për shërbimet mjedisore dhe angazhimi ynë si institucion do të jetë maksimal. Ky është një projekt me vlera, veçanërisht për komunitetin e kësaj zone.

Znj. Drita Dade, përfaqësuese e Bankës Botërore në Shqipëri, u shpreh e kënaqur që është arritur në këtë fazë të studimit. Ajo tha se ndjehej e kënaqur që për këtë studim u zgjodh Komuna e Ulëzës, jo vetëm për faktin se ka brenda saj një hidrocentral, por edhe sepse Ulza ka qenë e përfshirë edhe gjatë projektit të kaluar të BB. Për këtë ekziston edhe një bazë të dhënash, por, sipas saj, mbeten problem planet e menaxhimit, për të cilat janë financiar shumta të konsiderueshme por nuk janë plotësisht të sakta. Për sa i përket studimit në fjalë, ajo tha se është studim relativisht i vogël, por që do të na ndihmojë të kemi disa të dhëna, që t'i bindim politikëbërësit, kompanitë e ujërave, apo të energjisë, të jenë pjesë e këtij mekanizmi dhe të përfitojnë të ardhura. Zonja Dade theksoi se donatorë si SIDA dhe BB kanë mbështetur gjithmonë pyjet komunale dhe se këta donatorë janë akoma të interesuar, prandaj është i rëndësishëm modelimi sa më i mirë e pilotimi i disa mekanizmave për shërbimet mjedisore. Është e nevojshme që të shohim edhe agjenci të tjera, për të pasur

burime të reja dhe të vazhdueshme financimi.

Z. Peter Kampen, drejtor i këtij projekti dhe përfaqësues i SNV, Ballkan, beri një prezantim të shkurtër të projektit. Ai tha se ky është takimi i dytë që realizohet në kuadër të tij, pas atij të zhvilluar në Kosovë për sekuestrimin e karbonit. Z. Peter theksoi që ky studim nuk duhet të ngelet vetëm në kuadrin shkencor, por në të të përfshihen njerëzit që merren

drejtpërdrejt me basenin ujëmbledhës (DSHP, Shoqatat e përdoruesve, njerëzit përreth, etj). Një nga sfidat tona është të tregojmë sa fitim kemi nga kjo, tha ai dhe nënvizoi se në këtë takim kemi mundësi të njihemi me projektin, por të presim komentet tuaja në lidhje me metodologjinë apo çfarëdo sugjerimi tjetër.



Z. Janaq Male, përfaqësues i SNV, bëri një vështrim të përgjithshëm të situatës së pyjeve në Shqipëri dhe se sa ndikon ky sektor në ekonominë e vendit dhe sektorët e tjerë.

Z. Isuf Omuri, përfaqësues po nga SNV, paraqiti aspekte teknike të studimit me temë: "Metodologjia e propozuar për vlerësimin e influencës së praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës mbi erozionin, të dhëna për pyjet dhe ujëmbledhësin".

Z. Avdulla Diku, përfaqësues i PZHBN, në bashkëpunim me **Prof. Fran Gjokën**, përfaqësues i Diava Consulting, paraqitën temën "Metodologjia për matjen e erozionit të tokës dhe vlerësimin e impaktit". Ndërsa **Znj. Mimoza Koka**, po përfaqësuese e Diava Consulting, paraqiti temën "Metodologjia për identifikimin e aktorëve në rrjedhën e sipërme dhe analizat ekonomike të përdorimit të tokës. Analizat e aktorëve në rrjedhjen e poshtme, kuptimi dhe vullneti për konceptin e pagesave mjedisore".

Kryetari i Komunës Suç, përgëzoi ndërmarrjen e nismave të tilla dhe shprehu mbështetjen për projekte të kësaj natyre, të cilat do të ndihmonin në uljen e nivelit të erozionit.

Z. Haki Kola:

- Një Projekt i Federatës Dibër, për mbrojtjen e përroit të Tominit psh, banorët mund të kërkojnë çfarë na jepni ju që të ndalojmë kullotjen? Të ishte pak më e qartë në studim Status Quo.

- Pagesat për Shërbimet Mjedisore kërkojnë një studim të qartë dhe përcaktim të nevojave.

- Do përdorim Planet e Menaxhimit ekzistuese, bujqësia është po ashtu shumë e ndjeshme, kullotja ka problemet e veta dhe në këtë kuadër praktikant ndryshojnë dhe palët do të jenë të interesuara të paguajnë më pak.

- Ta shtrijmë këtë studim edhe më tej jo vetëm tek erozioni, por edhe tek cilësia e ujit, mbrojtja e biodiversitetit, etj. Momenti është që të gjejmë mënyrën që të lidhen sa më mirë të gjitha këto shërbime.

Z. Gjon Fierza:

- Projekti ka sfida përpara për të nxjerrë një metodologji; çfarë do sugjerojë? Kush do të përfitojë drejtpërdrejt? Kush do të jetë donator? Cilat do të jenë mekanizmat?

- Në basenin e Matit ndryshon problematika nga basenet e tjera, pasi pyjet e lartë për këtë basen janë të mbishfrytëzuara, edhe kullotja problematike, etj.

Drejtori i DSHP-se:

- Rritja e jetëgjatësisë do të rrisë të ardhurat.

- Ndikon edhe në shkallë kombëtare.

Në fund, **Z. Peter** tha se do të finalizohet metodologjia për zbatimin e projektit në fillim të marsit; pastaj të përcaktohen sipërfaqet prove për erozionin, menaxhimin e pyjeve, përfshirja e aktorëve, hapja e një faqe interneti e kështu me radhë. Ai tha se ka punë për t'u berë deri në fund të analizës dhe se do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë për sugjerimet dhe komentet e të pranishmëve.

Kur del nga shërbimi

Nga pranvera deri në vjeshtë, gjethet e pemës punojnë pa pushim e pa u ndier për të prodhuar frutat e shijshëm, aq të pëlqyer e të nevojshëm për organizmin tonë. Në vjeshtë, pasi kanë kryer "misionin" e tyre, ato rrëzohen nga degët e pemëve dhe bien në tokë. Gjithnjë rastis që ne kalojmë dhe shkelim mbi këto gjethë, të cilat kanë shërbyer

për të na prodhuar, fjala bie, frutat e dardhës, mollës, qershisë, etj. Por, as që na vete mendja për t'u treguar mirënjohjen atyre. "Ç'të bësh?! Kështu është jeta!". Kur ia ke nevojën, ia di rëndësinë, por kur nuk pret më prej saj, e shkel me këmbë, pa ndier aspak dhimbje.

Kështu ndodh, jo vetëm me gjethet, po edhe me kategoritë e tjera, pa kontributin e të cilave jeta jonë normale është e pamundur.

Që të luftohet varfëria

Duhet ditur se po deshe të luftosh varfërinë, duhet zhdukur prapambetja. Ajo është bindje e si e tillë kërkon organizimin dhe edukimin cilësor të komunitetit. Së pari, duhet kuptuar se varfëria nuk bie nga Qielli se ai është i shenjtë, nuk mbin nga Toka, se ajo është e shenjtë. Atëherë, nga na vjen varfëria? Padyshim, ajo është

shuma e çmimit të faturave të gabimeve tona: psh, ne shqiptarët bëjmë 20 herë më shumë gabime se francezët, kështuqë jemi rreth 20 herë më të varfër se ata.

Së dyti, nevojitet të njohim rolin që luajmë ne për t'u larguar nga varfëria. Po ashtu, duhen njohur mirë pasuritë që ka vendi ynë: pasuri natyrore, njerëzore, materiale, teknologjike etj. Duhet të ulemi e të programojmë gjithë çfarë duhet bërë që të mobilizojmë

faktorët që përbëjnë kapacitete, pa harruar edhe strukturimin e fuqizimin e administratës.

Për t'i arritur këto, duhet njeriu i talentuar e që i njeh problemet, që i di kriteret dhe rrugët që duhen ndjekur për të arritur sa më shpejt synimet, duke i krijuar mundësi shoqërisë që të jetë e mirinformuar, e mirorganizuar dhe e mirfinancuar. Vetëm kështu, jeta bëhet e sigurt.

Përgatiti A. Osja

Pylli ndërmjet tenderit dhe kujdestarit real shekullor ...

Vijon nga fq. 1

200 fshatra në Dibër, Kukës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan e Durrës, krahas programeve të tjera të trajnimit për forcimin e kapaciteteve të SHPPKK. Sot kemi 240 komuna me 240 SHPPKK, që kanë strukturë të brishta, të krijuara gjatë këtyre viteve, dhe 10 Federata, të krijuara me pjesëmarrje të gjerë e me votim të rregullt janë një organizim me pjesëmarrje shumë të gjerë dhe janë aset i rëndësishëm e faktor për të ndihmuar në qeverisjen e pyjeve dhe kullotave. Në të gjitha takimet, ku kanë qenë kryesisht fermerë, drejtues shoqatash e komunash dhe specialistë të DSHP, kanë dalë probleme të shumta e mjaft të rëndësishme, të cilat po i sjellim shkurt në vazhdim.

Problemi i pronësisë

Historikisht fshati ka pasur kufijtë e vet edhe pse është shtuar gradualisht, të gjithë banorët mbajnë mend edhe sot kufijtë e njëri-tjetrit për pyjet që kanë pasur para vitit 1945. Janë hartuar 24 plane menaxhimi nga USAID ose APFDP dhe janë përcaktuar përdoruesit për çdo ngastër, si 120 plane menaxhimi nga Projekti i BB, ku janë përcaktuar për çdo fshat e ngastër përdoruesit tradicionalë, konfirmuar me vendime nga fshati e komuna. Secili mund ta provojë këtë trashëgimi në një mënyrë shumë të thjeshtë, megjithëse pyjet e kullotat nuk ishin të ndara me kufij midis fshatrave, megjithëse shteti nuk kishte asnjë hartë apo regjistër për kufijtë e fshatit apo familjes, në vitin 1990, kudo që u provua, u vërejt se komisionet me përfaqësues të fshatrave i gjetën dhe se shumica i kanë pranuar reciprokisht këta kufij, që vinin qysh nga kanonet e vendosur nga vetë fshatarët. Në 240 planet e reja dhe rishikimet e PZHBN ka pasur një ndarje që po ta shohësh me vëmendje, janë më shumë neglizhime për të ndarë përdoruesit për shkak të pagës së vogël në hartimin e planeve, sesa gjendja reale e pronarëve tradicionalë. Po të shkosh në fshatra, nga Elbasani (lumi Shkumbin) deri në Vermosh, shumica e pronave kanë kufij tradicionalë dhe asnjëri nuk futet në pyjet e komshiut për të prerë dru ose gjeth. Flasin gjithmonë për pyjet e dushkut në afërsi të fshatrave, që në 1990 pothuaj u kishin ngelur vetëm rrënjët ... dhe këto janë rreth 400 mijë ha!

Kur këto probleme ngriheshin me përgjegjësi me bordet e DSHP në Dibër, Burrel e Bulqizë, Kukës e Elbasan, bordi i Federatës Kombëtare ishte i dety-

Tenderi është për të prerë drurët e mëdhenj, për të marrë çfarë mundesh dhe për të braktisur pyllin. Kjo ka ndodhur 20 vitet e fundit dhe quhet e ligjshme.

Ndryshe nga ky ligj shkatërrues e gënjeshtar, përdoruesi tradicional dhe kujdestari, jetojnë me pyllin; ata kujdesen për ngritjen pas prerjes, për mosdjegjen pas prerjes. Ministria ne 20 vitet e fundit zhvillon vetëm tenderin e prerjes apo mbjelljes. Aty kacafyten të fortët. Më pas, fidanët që mbillen apo filizat që duan të mbijnë nga pylli i prerë, gjenden pa mbrojtje, nën zjarr, kullotje e shkatërrim ...

Tenderi duhet për të plotësuar nevojat e tregut. Shitja është 10 herë më pak se prerja vjetore. 90 % e prerjes është spontane dhe prerja spontane, ashtu si ajo e tenderit, nuk pasohet me kujdesim për ngritje. Pyjet tona nuk shkatërrohen se priten, por se u mungon kujdesi e trajtohen keq, si në prerje edhe pas saj. Rezultati është nën zero, shkatërrimi vjen si ortek, pasi mungon kujdestari i pyllit. Mos shteti ka frikë nga kujdestari, pasi ai kujtudo do i kërkojë kujdes. Për këtë kujdes e për ngritjen e pyllit e duam kujdestarin. E duam pyllin të shkojë tek i zoti e të vihet nën kujdes ...

ruar në vitin 2008 të shikonte gjendjen në Shkodër, Lezhë e Tiranë dhe nga të gjitha takimet delte e njëjta gjendje. Konferenca Kombëtare e Tokës dhe mbështetja që dha Sida-2, krijoi mundësi të reja për të parë gjendjen, prandaj filluan takimet në të gjitha rajonet, por me projekte-pilot u punua në 16 komuna dhe nga informacionet e deritanishme del se mbi 60 % e përdoruesve në Melan, Malzi, Shllak, etj., janë përdorues që fshati i njëjtit historikisht, prandaj ata po certifikohen për t'i marrë pyjet në përdorim (në fakt ata i kërkojnë në pronësi) me mbështetjen e BB, qeverisë suedeze e SNV.

Ndryshe nga realiteti

Pylli shqiptar është tepër i copëzuar, pjesë e relievit dhe e peizazhit. Ndryshe nga realiteti që përmendëm më lart, historikisht, si politikisht pyjore, edhe vetë shkollat, e kanë larguar vëmendjen nga pylli me përmasa të vogla apo nga produktet për nevojat bazë të popullsisë për ngrohje e gatim, duke i shmangur nga sistemet e menaxhimit e të kontrollit lokal. Ata janë orientuar drejt regjimeve të menaxhimit në përmasa të mëdha, të drejtuara nga tregu, ku kontrolli u është deleguar autoriteteve të qeverisë qendrore, të përqendruar në zonat urbane. Kjo ka qenë dhe mbetet arsyeja kryesore që shumë nga drejtuesit e institucioneve shtetërore dhe të botës akademike, kanë frikë se reformat dhe pronësia private do të copëzojë pyjet dhe mundësinë e menaxhimit në mënyrën e konceptuar e mësuar deri më sot! Është pabesueshme që edhe shkolla, dijet apo politikë, vazhdojnë të rezistojnë e t'i qëndrojnë larg kësaj sfide, pa

kapërcimin e së cilës nuk ka frenim të degradimit. Kjo politikë e vazhdueshme, e sofistikuar, e mosnjohjes, ka shkakuar humbje të pallogaritshme, shkatërrime e degradim, që në ditët tona po shtohen në mënyrë dramatike, duke përfshirë pyje, shtretër lumënjsh, kullota e çdo pëllëmbë të tokës pa zot.

Përdorimi dhe shërbimi për pyjet dhe kullotat private ...

Në shumë pjesë të botës, fermerët, barinjtë dhe joprofesionistë të tjerë, kanë menaxhuar pyje për mijëra vjet dhe vazhdojnë t'i menaxhojnë sot e kësaj dite. Në sytë e tyre vetë mjedisi pyjor dhe produktet jodrusore, shpesh janë më të rëndësishme se lënda e punimit. Kjo e fundit dhe produktet e tjera vijnë nga drurët që rriten në fermat pyjore apo nga zabelet përreth shtëpive.

Menaxhimi i bazuar në rregulla të pashkruara është mbizotërues, krahasuar me atë që bazohet në plane komplekse të mbarështimit të pyjeve dhe të pazbatuara deri më sot. Shumë është folur në literaturën pyjore për "avaritë" e sistemeve menaxhuese tradicionale, për shkak të faktorëve demografikë dhe në tensionin gjithmonë të pranishëm të tragjedisë së të përbashkëtës në menaxhimet kolektive. Kjo vërtetohet nga puna e bërë nga fermerët që janë monitoruar gjatë viteve 2007-2011. Në pyjet e tyre janë bërë mbi 120 sipërfaqe prove të përhershme në shumë parcela pyjore, që përdoren nga përdoruesit tradicionalë dhe rritja mesatare shkon 4-16 m³/ha dhe kjo

është kryesisht meritë e këtyre përdoruesve, në asnjë ngastër me përdorues tradicionalë, që e konsiderojnë pyllin të tyre, nuk janë bërë prerje rrafsh dhe dushku ka arritur mbi 15 m lartësi, vetëm nga mbrojtja që i siguron vetë pronari. Shumë nga përdoruesit tradicionalë kërkojnë t'i kenë pyjet në pronësi dhe kjo s'ka asnjë vështirësi për t'u arritur. Mjafton që gjithçka të parashihet në ligj. Në kushtet kur këta janë pronarë, por dhe përdorues, përcaktohen të drejtat dhe detyrat për të gjithë, duke filluar tek DSHP, komuna, fshati, pronari privat, si dhe roli i aktorëve të tjerë. Të gjitha këto vendosen në ligj dhe në rregulloret përkatëse dhe bëhen të detyrueshme për këdo. Prona e të gjithëve nuk është e askujt dhe të gjithë i vërsulen si deri me sot ... është provuar historikisht se asnjëherë njeriu nuk e prish shtëpinë e vet ku jeton. Duke vepruar në këtë mënyrë ne vetëm ligjërojmë pronat, pronarët dhe vendosim rregulla për të gjithë, monitorimin, kontrollin dhe politikën pastaj i bëjnë ekspertët në DSHP, Fakultet, Dikaster, etj. Këshillimin e bën grupi i ekspertëve në të gjitha nivelet, menaxhimin e bëjnë shoqatat me fshatarët dhe duke pasur ekspertë në komuna e shoqata.

Vendi ynë ka mëse dy milionë ha pyje, kullota, sipërfaqe djerr e improduktive, etj. dhe në fakt janë pak rreth 2000 ekspertë të fushave të pyjeve, që duhet të realizojnë të gjitha shërbimet dhe monitorimin e kontrollin, menaxhimin e tyre. Por, të gjitha këto bëhen kur ndahen rolet dhe përgjegjësitë me ligj e jo me urdhra, siç veprohet sot. Pastaj, ekspertët kudo që të jenë duhet të motivohen për punën që bëjnë. Kjo është rruga që kanë përdorur vendet e zhvilluara dhe i kanë futur pyjet në tregun formal, kanë marrë investime për zhvillimin rural, duke u adresuar nga shteti kryesisht tek privati për mbjellje e shërbime të tjera, jo vetëm me akacie e pisha, po edhe me arrë e lajthi, gështenja e bajame, që përveç vlerave ekologjike kanë edhe vlera ekonomike. Ne nuk ecim në rrugë të panjohura; modelet janë të shumta, në radhe të parë nga komunitetet rurale, që menaxhojnë në mënyrë të shkëlqyer tradicionalisht pyjet e veta, përdoruesit tradicionalë që janë përdorues e pronarë ndër shekuj të pronave të tyre. Vetëm po të marrim Kosovën, ku kemi parë dhjetëra herë, po dhe siç njofton APK, pyjet e privatëve janë më të mirë se ato shtetërore ...

Jo vetëm në Slloveni, po edhe në Austri, Zvicër e Suedi, ka edhe pronarë me 1 ha tokë pyjore, por kriteri i menaxhimit vendoset për të gjithë dhe të gjithë janë të detyruar të zbatojnë menaxhimin e

qëndrueshëm; kush e shkel ndëshkohet. Edhe tek ne le të veprojnë ligji ... Veç, jo strukturat nën të njëjtën përgjegjësi, po të ndara, siç i ka gjithë bota ku duam të integrohemi.

Analiza që s'u bënë asnjëherë. Pasojat e tenderëve 1992-2012

Megjithëse i shpërndarë shpateve e luginave, shpesh të thepisura, me përmasa modeste, që të çorientojnë kur futesh në brendësi, politikëbërësit e ndonjëherë edhe librashkruesit, e kanë klasifikuar si të madh e industrial pyllin shqiptar. Me gjithë thirrjet e kohë pas kohshme të ekspertëve e Federatave të Pyjeve përpara se të dëmtohen masivisht pyjet e larta të Shqipërisë (sepse pyjet e ulëta, veçanërisht dushkajat, ishin dëmtuar masivisht para vitit 1990), për të analizuar mundësitë e këtyre pyjeve dhe nevojat e të drejtat e komunitetit, asnjëherë nuk u bë ndonjë debat kombëtar se si do ta orientonte kombi shqiptar atë pak pyll që i vishte malet e tij të reja tekanjoze.

Analiza duhet bëhej mbi bazën e asaj që pylli të jepte, duhej shërbimi i tij për të ruajtur ujën e tokën, të analizohet nëse tepronte ndonjë gjë për në treg apo prodhimi do plotësonte nevojat e familjeve, veçanërisht një pyll që duhej të luante edhe rolin e kullotës për bagëtitë e banorëve që kishte strehuar. Tani që pyjet pothuaj u mbaruan, duket se do fillojë debati se ku është më mirë të merren vendimet menaxhuese, të jenë vendorët apo të ketë vendimmarrje shteti, ku çdo militant politik të jetoje me shpresën se akoma ka edhe pak për të rrëmbyer, si vitin e kaluar, kur u sulmua dhe Zalli i Gjocajt e Parqet (!!!?), të vetmet zona me pyje të lartë të mbetura nga tenderët që nuk u kursyen për 20 vjet, duke rrafshuar mijëra ha me pishë e ah.

Këto analiza s'u bënë asnjëherë, po mbizotëroi tenderi me njerëz të babëzitur për të fituar sa më shumë, por që edhe sot hakërrehen si çakej për të kapur ndonjë copë pyll për ta prerë. Prapa firmave fantazmë ka struktura të shtetit që akoma guxojnë e tentojnë të mbajnë në pronësi disa copa të paprera, për tu bërë mëkatarë, po që një ditë do t'i vuajnë. Këto struktura guxojnë që dhe kur Kryeministri thotë se shteti duhet të mbajë në pronësi vetëm 10 % të territorit të pyjeve e kullotave, përpiqen me të gjitha format e rrugët, jo vetëm ta zvarrisin procesin, po edhe ta deformojnë e të krijojnë gjithfarë vështirësish, që reforma të vazhdojë pafundësisht, për të parë të prerë çdo dru në këmbë, për të vrrarë çdo kafshë ose shpend ...

Pata të egra në shtegtim...

...pa ditur si do të përfundojnë!?



nga THEMI PERRI



Masakër e vërtetë ndaj faunës së egër në ditët e dimrit të acartë

Më vjen keq t'i nis kështu këto radhe për gazetën "Kurora e Gjelbër", por fakti është fakt. Pamje të shfaqura në ekranet e televizioneve dhe njoftime nga terreni janë të frikshme. Në një kohë kur shtetet e rajonit e më gjerë e mbyllën gjuetinë, tek ne sheh dyndje njerëzish, madje edhe në moshë të mitura, me armë në dorë, mësyjnë në ara e laguna për të bërë kërdinë mbi shpendët e pambrojtura, të ardhura nga larg, për shkak të të ftohtit të acartë. Për rosat e patat e egra që fluturonin në lartësi, u përdorën edhe armë zjarri, që mbahen akoma qysh nga viti '97. Pra, natyra jonë tregohet bujare, që i pranon, ndërsa ne vetë dalim e i vrasim ose i përzëmë për andej nga kanë ardhur. Kjo është e turpshme por edhe e pafalshme, pasi do të lypset shumë punë e kohë të kthehemi në normalitet. Por, është e lehtë të protestojmë, të ankohemi e të revoltohemi, po a mund të bindet me fjale hajduti që të mos vjedhë. Jeta na mëson se kjo rrallë mund të ndodhë. Prandaj vepron ligji. Edhe në këtë rast ai duhet të veprojë pa mëshirë për ata që faunën e quajnë pronë të tyre. E themi këtë se në të gjitha ditët e të ftohtit të madh, në zonën nga Velipojë në Butrint me të gjitha llojet e armëve u masakruan kope të tëra patash e rosash të egra, të ardhura nga larg për t'u në vendin tonë dhe nuk dëgjua asnjë zyrtar ...

Po, social të ndodhë kjo. Veç faktorëve socialë dhe ekonomikë, do të përmendja faktin që tek ne mund të gjuajë kushdo që ka një armë gjahu. Policia pyjore, jo se nuk ka vullnet, po nuk i ka kapacitet e nevojshme, logjistikën dhe mbështetjen për të kryer detyrën. Pushteti vendor shpesh është indiferent edhe pse 60 % të pyjeve e kullotave i ka marrë në përdorim. Shoqatat e gjuetarëve janë në minorancë. Të shumtë, "të fortët" bëjnë ligjin në ushtrimin e gjuetisë, duke mos pasur kurrfarë lidhje me të. Janë rreth 150 mijë armëmbajtës, pjesa më e madhe e të cilëve i përdorin ato për gjah. Vetëm 9 % janë të anëtarësuar në shoqata, janë të kualifikuar dhe shlyejnë detyrimet karshi shtetit për t'u pajisur me leje gjuetie. Këtë ua lejon ligji i gjuetisë, ligji i pabesueshëm, kontrollueshëm e i zbatueshëm.

Pra, siç thotë populli "Është për të venë duart në kokë". Por nga qarja nuk del gjë. Duke u ndodhur përpara një gjendje të tillë, Këshilli Kombëtar i Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë, e analizoi atë me ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe "trokiti" në të gjitha dyert që kanë në dorë të veprojnë për ndryshimin e gjendjes. Por, të paktën të na kthen dikush një përgjigje. E, çfarë kemi kërkuar? As më pak e as më shumë, atë çfarë kanë kolegët tanë në rajon e më gjerë: Të bëhet edhe tek ne gjueti e kontrolluar, e qëndrueshme e në përputhje me standardet evropiane. Më konkretisht:

- Në tërësi, në kundërshtim me kushtet bioekologjike tepër të favorshme që ka vendi ynë, "Ekonomia e Gjahut" gjendet në situatë ekstremisht të vështirë, me prirje përkeqësimi, nga pakësimi i llojeve të gjahut dhe i numrit të krerëve që mund të vilen çdo vit, si për gjahun autokton (reduktuar nga disa dhjetëra në vetëm 3-4 lloje), ashtu edhe për atë shtegtar.
- Edhe për llojet që akoma mund të gjuhen, si lepuri i egër dhe thëllëza e malit, ndër autoktonët dhe shapka, turtulli, shkurtëza e disa lloje rosash nga shtegtarët, popullatat e tyre janë në regres të vazhdueshëm, që po të vazhdojë kështu do të çojë shpejt në shfarosjen edhe të këtyre llojeve!!!
- Popullatat e llojeve kryesore të gjahut autokton, si kaprolli, derri i egër, dhia e egër, gjeli i egër, thëllëza e fushës, etj, të cilat prej 4-5 dekadash mbrohen me ligj, jo vetëm nuk e kanë marrë veten, por gjenden në shuarje e sipër në shumicën e zonave të përhapjes së tyre natyrale. Në ndryshim nga kjo, kudo në Evropë, po edhe në vendet fqinje këto lloje zhvillohen duke siguruar jo vetëm gjueti cilësor, po edhe të ardhura vjetore të rëndësishme edhe për vendet e zhvilluara.

Këshilli Kombëtar i Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë mendon se këto dukuri shkatërruese vijnë nga një seri shkaqesh tërësisht subjektive, si:

- Ashtuquajtura "Gjueti turistik", e cila drejtohet nga një numër personash të miratuar nga MMPAU, duhet të ushtrohet duke respektuar rregullat, si për sa i përket sasisë së gjuetarëve të huaj që vijnë tek ne, ashtu dhe llojit të gjahut e numrit të krerëve që duhet të gjuajnë, mënyrës së ushtrimit të gjuetisë, pagesën që duhet të bëjnë, rregullat që duhet të zbatohen, etj, kërkesa këto të shkruara e sanksionuara me ligj. Por, në realitet ndodh diçka që është vështirë të përshkruhet pa ndihmën e filmimeve e fotografive dhe akoma më vështirë të besohet. Vijnë pa kufizim e valëvalë gjuetarë të huaj (kryesisht italianë), shkojnë ku të duan e ku të mundin, vrasin çfarë e sa të gjejnë e me çfarëdo lloj mjete, përfshirë edhe imitues elektronikë të shfarosjes në masë, të cilët në vendin e tyre nuk guxojnë t'i përdorin!? Këta gjuetarë të huaj nxisin edhe një dukuri tjetër të rrezikshme, siç është blerja e gjahut të vranë nga gjuetarë shqiptarë ose nga matrapazë, që përbëjnë dorën e dytë midis gjuetarëve vendas e atyre të huaj. Kjo bëhet e mundur sepse diferencat e çmimeve të mishit të gjahut tek ne dhe jashtë janë shumë të mëdha. Dhe ndodh kështu prej disa vjetësh kjo masakër pamjet e të cilës i gjejmë edhe në mjaft kronika televizive të mjaft të kanaleve shqiptare shtetërore e private.

b) Lejimi nga ana e shtetit i mbajtjes së armëve të gjuetisë nga kushdo, pa kufizim dhe në mënyrë të pakushtëzuar, gjë që përbën shkak tjetër, që ndikon fuqishëm në shfarosjen e gjahut. Mjafton të kemi parasysh faktin se ndërsa në shoqatat dhe Federatën e Gjuetarëve janë rreth 10 mijë anëtarë të pajisur me armë gjuetie, kurse në terren ekzistojnë në duart e popullsisë mbi 150 mijë të tilla, të shpërndara në mënyrë kapilare në të gjithë territorin!?

c) Defektet e ligjit të gjuetisë, sidomos lidhur me mundësinë e krijimit në mënyrë të pakufizuar të mëse një shoqate gjuetarësh brenda një njësie administrative vendore (grupime dhe me gjuetarë të përjashtuar nga shoqata si shkelës të ligjit) dhe të mëse një Federate në shkallë vendi, gjë që ka sjellë daljen jashtë kontrollit të këtij aktiviteti, i cili edhe pse ka karakter çlodhës, rikrijues e sportiv, ka edhe karakter jo të neglizhueshëm ekonomik, që shpesh edhe pse nuk thuhet, del në plan të parë.

Për të frenuar procesin e degradimit të natyrës, lidhur me dukuritë dhe shkaqet e mësipërme, Këshilli Kombëtar e FGJSH propozon që të merren disa masa, që janë vetëm në dorë të shtetit. Më konkretisht:

- Të miratohet një moratorium për ndalimin e gjuetisë se të huajve dhe tregtimin e mishit të kafshëve e shpendëve të egra për 4 vjet.

- Ministria e Brendshme, përmes komisarivateve të policisë, në bashkëpunim me shoqatat e gjuetarëve e pushtetin vendor, të bëjnë vulosjen përfundimtare të të gjitha armëve të gjuetisë për personat që nuk janë anëtarë të shoqatave të gjuetarëve dhe për periudhën kur sezoni i gjuetisë është i mbyllur për gjuetarët e regjistruar anëtarë shoqatash që paguajnë sipas rregullave dhe ligjeve të shtetit.

- Të kufizohet e kontrollohet aktiviteti i dyqaneve të armëve të gjuetisë, duke u ndaluar atyre sjelljen dhe tregtimin e imituesve të të gjitha llojeve.

- Komisioni i Veprimtarive Prodhuese në Kuvendin e Shqipërisë dhe MMPAU të marrin në konsideratë kërkesat që Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë ka formuluar për amendimin e ligjit të gjuetisë dhe të ndihmojnë për ta kaluar në Parlament.

Këto dhe të tjera me interes në mbrojtjen e zhvillimin e faunës së gjuetisë kërkon një komunitet i tërë, gjuetarë e jo gjuetarë. Por, asgjë ... heshtje dhe vetëm heshtje. Mos ka ardhur koha të bllokohen (vulosen) të gjitha armët e gjahut për një periudhë të pacaktuar, siç u vepra dhe me skafet? Po një ligj gjuetie i pazbatueshmen kujt i duhet? A ka nevojë ai për ndryshime? Federata dhe shoqatat e gjuetarëve janë të gatshme për të ndihmuar këtë proces. Shteti duhet ta kthejë vëmendjen edhe nga kjo pasuri e madhe publike.

Të vrasësh një qenie të gjalle në ditën më të lige të jetës

Mendime e sugjerime për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë ...

HAKIKOLA

Këtë mot të pazakontë, u krijuan probleme të jashtëzakonshme edhe për qeniet e gjalla, që jetojnë më afër natyrës dhe nuk e kanë komoditetin dhe forcën e njeriut. Zoti u dha shpirt dhe të drejtën e jetës në globin ku ne jetojmë. I kemi bashkëglobas, që shpesh u thurim edhe krijime të bukura. Ndajmë me ta hapësirën e jetës. Në çdo vend normal, të gjitha strukturat në këtë stad duhet të ishin duke kontribuar me ndihma, për fqinjët tanë, që veç se na zbukurojnë mjedisin, na pasurojnë jetën ...

Sot ato kërkojnë strehë për të mbijetuar. Ekipet njerëzore sot nuk duhet të ishin duke i gjuajtur, por duke kontribuar me ushqime për to. Me gjithë katastrofën e ndodhur, që ne të gjithë jemi dëshmitarë, përsëri është një farë sado e pakët që duhet ruajtur, për brezat e ardhshëm për të mirën e natyrës, shoqërisë dhe zhvillimit, kur të bëhemi ndonjëherë shtet normal. Fara duhet ruajtur sot. Ajo që ndodh sot është shfarosje dhe s'ka lidhje me gjuetinë. Është mirë, që nëse ekzistojnë hapësirat logjike e ligjore ta shpallim të ndaluar gjuetinë dhe të vëmë në mbrojtje ato pak relikte / të rralla, që na pëlqen të besojmë se vazhdojnë të jetojnë në hapësirën shqiptare.

ZAMIR DEDE

Pamje dhe informacione që vijnë nga terreni janë të frikshme ... skuadra të vogla banorësh nga zonat rurale (burra, fëmijë, gra) i pritën kafshët e shpendët e egra me të gjitha mjetet vrasëse, siç dimë të bëjmë vetëm ne. Prandaj, unë mendoj se thirrjet tona kanë pak vlerë se dëmi u bë dhe shpendët që arritën t'i shpëtonin masakrës, tashmë prehen të qeta jashtë territorit të vendit tonë. Më vjen turp kur mendoj se unë dhe të gjithë ne, jemi faktorë, në një formë a një tjetër, me heshtjen tonë, me mënyrat e arsytimit që të lejojmë gjuetinë se është sport i bukur, me mosgjydhjen e problemit të armatimit masiv të popullatës e të tjera si këto, të gjendemi sot në një rrugë pa krye e të frikshme. Është e kollajtë ta vëmë gishtin tek stafi i ministrisë apo pyjores, që kanë përgjegjësinë më të madhe, por, duhet t'i bëjmë apel vetes si të rregullohet kjo punë. Kemi arritur në piken zero dhe tashmë duhet shumë punë të kthehemi në normalitet. E kam të vështirë të them se ç'duhet bërë, po për një gjë jam i sigurt dhe besoj se biem dakord të gjithë: "Të ndalojmë gjuetinë për sa kohë nuk e kontrollojmë dot"; le të bëjmë atë që u bë me skafet dhe të fillojmë të debatojmë e kontribuojmë për ndreqjen e gjendjes.

REXHEP NDREU

Disa nisma që kanë ardhur nga gjuetarët e terrenit kanë qenë të ngjashme me idenë e z. Zamir "Të ndalojmë gjuetinë për disa vite", dikush thotë 1-3, dikush 5 vjet. Kjo është mirë të diskutohet së pari nga vetë gjuetarët e shoqatat e tyre dhe të propozojnë sa e si duhet vepruar për të mundësuar ndalimin e gjuetisë, llojet, kohën, vendin, periudhën, duke argumentuar shkaqet.

Në kushtet e dimrit të sivjetëm, mendoj se jo vetëm nuk duhet gjuajtur, por duhet të merren nisma për kujdes ndaj tyre, duke hedhur ushqime atje ku ka mundësi.

HAZIS PORJA

Gjuetia është sektor pothuaj i lënë pas dore. Për të ditur gjendjen e gjahut dhe të gjithë faunës, para se të bëjmë planifikime, duhen bërë studime dhe inventarizimi i përgjithshëm, pastaj të flitet për trajtim e vjelje gjahu. Megjithatë, nga përvoja, informacionet dhe sondazhet e kryera, dal në përfundimin që së pari të ndalohet me çdo kusht gjuetia e jashtëligjshme dhe, pas kësaj, është i domosdoshëm ndalimi i gjuetisë për 3-5 vjet në gjithë vendin ose, në pamundësi, me qarkullim me rrethe, pra për tre ose për 5 vjet, duke ndaluar gjuetinë në 1/3 ose 1/5 e gjithë vendit, kjo në mënyrë të studiuar, sipas llojeve, biologjisë se tyre dhe arealit të qëndrimit dhe të kullotës.

DURIM KABA

Dëmtimi i faunës në vendin tonë ka ardhur jo vetëm nga gjuetia e pakontrolluar apo nga moskujdesi për shtimin e saj (me forma të ndryshme nga persona të interesuar si psh: anëtarët e shoqatave të gjuetarëve), po edhe nga dëmtimi i habitateve ku ushqehen, strehohen e riprodhohen kafshët e egra. Ndërgjegjësimi për mbrojtjen dhe shtimin e kafshëve të egra duhet bërë tek të gjithë ata që gjuajnë apo kryejnë aktivitete të ndryshme në pyje e kullota.

ISUF SALLA

Gjuetia e sotme nuk është sportive, por gjakatare. I gjithë populli është i armatosur dhe mua më duket që në pritë sot janë që nga moshë 15 deri në 75 vjeç. Bilë ka edhe shumë gra gjahtarë. Mendoj që një dekadë të mos gjuhet, sepse nuk gjen më në pyll as derr, as kaproll, as dhi të egër ... Kjo nismë është e mirë.

JAKOV BODURRI

Në ditë të vështira, ndjenja e tolerancës dhe solidaritetit duhet të jetë edhe ndaj kafshëve e shpendëve të egra.

Bimët tona mjekësore në tregun botëror

Prof. Dr. AHMET OSJA

Lidhjet midis njeriut dhe bimëve kanë qenë mjaft të ngushta që në fillim e gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Me intuitën e tij, njeriu që në lashtësi hetoi se përdorimi i disa bimëve përmirësonte gjendjen shëndetësore të tij, duke sjellë lehtësim por edhe kurim të sëmundjeve të ndryshme. Kështu, dalëngadalë, njeriu filloi të dallojë midis sasisë së madhe të bimëve, ato që kishin veti që t'i lehtësonin sëmundje të caktuara.

Grumbullimi gradual i njohurive mbi vetitë mjekësore që kishin disa bimë, mundësoi trashëgiminë gjithnjë në rritje të përdorimit të këtyre bimëve, në hartimin e recetave të përshtatshme: mënyrës së përgatitjes dhe mënyrës së përdorimit.

Në materialet arkeologjike janë gjetur shumë mjete dhe vizatime që dëshmojnë për përdorimin e disa bimëve nga njeriu, po kështu edhe autorët antikë kanë shkruar deri edhe libra të veçantë rreth përdorimit të bimëve mjekësore, si dhe kanë përshkruar si mbilleshin, kultivoheshin e përdoroheshin ato; çfarë sëmundjesh mund të shëroheshin me lloje të veçanta bimësh. Në traditën e popullit tonë është për t'u përmendur mbreti ilir Genti, i cili njihte e përdorte shumë lloje bimësh. Por rreth vetes kishte edhe mjaft njerëz të tjerë që i njihnin dhe përdornin shumë lloje me veti kuruese.

Që nga antikiteti e deri në shekullin XVIII, mbi 90 % e barnave të përdorura e të përshkruara, ishin me origjinë bimore.

Kërkimet e fundit po vërtetojnë gjithnjë e më shumë se përdorimi i bimëve mjekësore në shërimin e shumë sëmundjeve është mjaft efikas, nuk ka efekte anësore dhe kanë kosto relativisht të ulët krahasuar me ilaçet e tjera.

Vendi ynë është mjaft i pasur me bimë mjekësore, aromatike e tanifere. Ato, jo vetëm gjenden në sasi të konsiderueshme, por janë edhe shumë cilësore. Sipas studimeve, bimët mjekësore dhe aromatike janë të për-

hapura në të gjithë vendin. Gjenden në sasi të mëdha në Malësinë e Madhe, Shkodër, Pukë, Tropojë, Dibër, Mat, Pogradec, Korçë, Kolonjë, Skrapar, Përmet, Tepelenë, etj.

Shqipëria vazhdon të ruajë në tregun botëror një vend kryesor, kryesisht në SHBA, Gjermani, Francë, Itali, etj. Sipas disa të dhënave del se nga eksporti i këtyre bimëve fitohen mbi 20 milionë dollarë në vit. Por, mundësitë janë për dhjetëfishimin e kësaj vlere. Por që të arrihet kjo, lypset që bimët të grumbullohen, përpunohen e përgatiten sipas kërkesave të tregut. Roli ynë sot në tregjet ndërkombëtare të bimëve mjekësore e aromatike është i tillë, sa që për disa produkte, një lëvizje çmimesh nga operatorët tanë, do të lëvizte çmimet në nivel botëror.

Kjo pasuri me vlera të konsiderueshme duhet të përbëjë një mundësi për t'u shfrytëzuar me kujdes dhe brenda gjithë rregullave, përndryshe grumbullimi pa kriter, jo vetëm çon në uljen e vlerave, por mund të çojë edhe në zhdukjen e tyre, ç'ka do të thotë që të përballemi me pasojat të pakorrigjueshme. Fakt është që sot kemi krahina që para 30-40 vitesh ishin të pasura me një bimë të caktuar, por duke i grumbulluar pa kriter, janë dëmtuar rëndë. Shembull për këtë është zona e Taraboshit në Shkodër, ku në vitet 50-60 të shekullit të kaluar kishte sasi të mëdha e mjaft cilësore të bimës së sherbelës. Por, duke u grumbulluar jashtë kriterëve, sot gjendja është kritike.

Ka ardhur koha që, për të shpëtuar nga këto katastrofa, të fillojmë kultivimin e tyre. Një rol me rëndësi duhet të luajnë edhe shoqatat e përdorimit të pyjeve e kullotave komunale. Nga ana tjetër, shteti duhet të shikojë mundësinë e subvencioneve, pasi kështu krijohen kushte për rritjen e të ardhurave në zonat rurale, rritet eksporti, por sigurohet dhe pjesëmarrje sezonale e mbi njëqindmijë të punësuarve. Ndërkohë që me fillimin e kultivimit të këtyre bimëve, bëhet e mundur ruaj-

tja e një sipërfaqeje toke jetike, që po të lihet e pa kultivuar, bëhet objekt i gërryerjeve dhe largimit të shtresës aktive të tokës. Fakt është që në këto zona, sot ka mjaft toka të lira, të pakultivuara. Në shkallë vendi kemi përvojë të grumbulluar në vite, që shërben si mundësi për t'u shfrytëzuar. Mjafton të kemi parasysh rajonin e Postopojës në Kopluk të Malësisë së Madhe, ku në vitet '70 të shekullit të kaluar janë kultivuar rreth 1000 ha me bimë eterovajore e mjekësore. Një kontribut të rëndësishëm për këtë pati agronomi i përkushtuar Kiço Çeku. Në këtë zonë, banorët sot po i rikthehen traditës. Deri tani janë mbjellë me bimë eterovajore aromatike mbi 600 hektarë. Po ashtu, kemi kushte për mbjelljen e sherbelës, kamomilit, rigonit, valerianës, gentianës, salepit, lavandës, trumzës, rozmarinës, etj. Me kultivimin e këtyre bimëve, përveç cilësisë më të lartë, mund të merren edhe rendimente të larta e të kemi prodhime të sigurta.

Me njohuritë bashkëkohore dhe mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm, flora natyrore nuk duhet shpërdorur, por përkundrazi, ajo duhet ruajtur e mirëmbajtur, përndryshe mund të arrish të fitosh në 2-3 vjet, por dëmi që shkaktohet nga zhdukja e bimëve është i pallogaritshëm. Për të risjellë një bimë në sipërfaqe të konsiderueshme natyrore është tepër e vështirë dhe e kushtueshme. Nga ana tjetër, është mjaft e rrezikshme të humbasim ndonjë përfaqësues nga flora autoktone apo origjinale. Kualifikimi i fermerëve është proces me shumë rëndësi, që kërkon vëmendje të veçantë, ku duhet parë seriozisht edhe specialistët që ofrojnë këtë shërbim.

Ndërkohë, kërkohet të mbështetet prodhimi i erëzave cilësore, i fidanëve të përshtatshëm dhe të rekomanduar për zonën përkatëse, të ngrihen laboratorë për të kryer analizat, të organizohen panairë brenda e jashtë vendit dhe të nxitet propaganda për këto prodhime, kur dimë që përqindja më e madhe e

trumzës që hyn në tregun gjerman sot, është prodhim shqiptar. Sezoni që fillon të mblidhet kjo bimë koincidon me periudhën kur mbyllen shkollat. Kështu, janë mundësitë që

të marrin pjesë edhe fëmijët dhe krahu tjetër i lirë i punës në këto zona. Kjo krijon kushte për të siguruar një burim të ardhurash për të cilin familjet rurale kanë shumë nevojë.



Bimët aromatike e mjekësore, mundësi shumëfishimi nëpërmjet kultivimit të llojeve të rrezikuara

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale

Nisur nga vlerat e gjithanshme ekonomike, ekologjike e shkencore, bimët aromatike e mjekësore përbejnë një pasuri natyrore me rëndësi të jashtëzakonshme, pasi ato janë lëndë e parë baze për industrinë farmaceutike dhe atë kozmetike. Ato janë të domosdoshme edhe për industrinë ushqimore dhe atë kimike. Po ashtu, mjekësia e sotme botërore ka prirje të përgjithshme strategjike drejt burimeve natyrore, për kërkime shkencore, për prodhimin e medikamenteve të reja me baze bimët mjekësore.

Si pasojë e shfrytëzimit jashtë kriterëve teknike, aktiviteti i këtyre bimëve ka shënuar rënie me rreth 1/3, me pasojat gjithmonë jo vetëm për komunitetin, por dhe në dëmtimin e mjedisit dhe vlerave të biodiversitetit.

Shqipëria është një rajon me shumë vlera për këto bimë. Ekziston një florë spontane shumë pasur me bimë mjekësore, si në sasi dhe në llojshmëri. Këtë e favorizon jo vetëm pozicioni gjeografik, klima e mikroklima por edhe relievi. Mbështetur në potencialet ekzistuese, aktiviteti i grumbullimit, përpunimit e tregtimit të këtyre bimëve mund të shumëfishohet nëpërmjet kultivimit dhe shtimit të llojeve të rrezikuara. Në këtë vështrim, kërkohet që të gjitha shoqatat e përdorimit të pyjeve dhe fermerët, në bashkëpunim me komunat, të fillojnë planifikimin jo vetëm për mbledhjen me kujdes, por dhe për shtimin e kultivimin e llojeve, sidomos atyre të rrezikuara. Nder llojet që propozon eksperti Zyber Gjoni për kultivim, me vlerë për eksportin por dhe për mjedisin janë: Mëllaga e bardhë (*A. officinalis* L.), Rrodhja e madhe (*A. lappa* L.), Helmarina (*A. belladonna* L.), Ciani (*C. cianus* L.), Sherbela (*S. officinalis* L.), Sanzi i verdhë (*G. lutea* L.), Molla e egër (*M. silvestris* Mill.), Kamomili (*M. recutita* L.), Barbleta (*M. officinalis* L.), Agulicja (*P. veris* L.), Trëndafili i egër (*R. canina* L.), Tërfili livadhori (*T. pratense* L.), por mundet të ketë dhe shumë lloje të tjera, që ekspertët duhet të rekomandojnë.

Vijon nga fq. 1

Fjala e Prof. Dr. Vath Tabaku

Pyjet dhe kullotat, të marra së bashku, zënë rreth 60 % të territorit të vendit (1.498.570 ha), duke krijuar iluzionin se në sipërfaqe pyjore Shqipëria është ndër vendet e para në Evropë. Por, në fakt, gjendja e tyre është tepër e rëndë, gjë që dëshpëron prej kohësh armatën e pylltarëve të vendit, të cilët kanë ushqyer dhe ushqejnë familjet e tyre me këtë profesion, pa përmendur këtu pasionin e tyre për pyjet dhe natyrën. Gjendja e rëndë e pyjeve,

është një problem i akumuluar prej më shumë se 20 vjetësh. Nga sistemi i kaluar, u trashëguua po ashtu një gjendje e rëndë e pyjeve, pasi shfrytëzohej disa herë më shumë se sa mundësia e shfrytëzimit. Me këtë prirje u vazhdua edhe më pas, duke i rrënuar kështu pyjet tona. Për rrjedhojë, sipërfaqe të mëdha me pyje në mbarë vendin janë prerë, djegur e degraduar plotësisht. Aktualisht:

- Vazhdohet të pritet më tepër material drusor se sa është mundësia reale e shfrytëzimit të pyjeve.
- Sektori pyjor vazhdon ende të mbetet pothuaj informal; rreth 70 % e materialit drusor të prerë tregtohet ilegalisht.

- Në shkallë vendi çdo vit humbasin miliona m³ tokë nga erozioni, shkatërrohen rruqet, përmythen fusha e qendra banimi dhe digjen mijëra hektarë pyje e kullota.

Nisur nga kjo gjendje, mendojmë se hartimi i një Plani Kombëtar për zhvillimin e sektorit pyjor në nivelin e duhur, kërkon ndjekjen e disa hapave të domosdoshme, të cilat shkurtimisht janë:

1. Fiksimi nga ana strategjike i politikave, që duhen ndjekur në pyje, lidhur me sistemin e pronësisë dhe konkretizimin e pritshmërisë së pronarëve (shtet, komunë, privat) ndaj pyjeve që disponojnë;

2. Rishikimi i Strategjisë për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave, në përputhje me ndryshimet e kohëve të fundit, duke e përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Rural, sikurse rekomandohet dhe nga politikat e konventat evropiane;
3. Përmirësimi i sistemit statistikor e informativ, për grumbullimin e të dhënave të sakta mbi gjendjen reale të pyjeve, kapacitetet aktuale dhe nevojat reale;
4. Hartimi, mbi bazën e këtyre të dhënave, i programit për zhvillimin e sektorit të pyjeve, nga grupe pune me specialistët më të mire të vendit në këtë fushë; "Bordi

Këshillimor i Pyjeve" i krijuar në prill të vitit të kaluar, duhet të ishte më efektiv.

5. Diskutimi i programit me palët e interesuara dhe miratimi i tij nga organet e larta shtetërore, duke përcaktuar saktë afatet për zbatimin e tij.

Stafi i Fakultetit tone është i bindur se, megjithëse do të duhet kohë për të kapërcyer pengesat dhe vështirësitë e mëdha që ekzistojnë, së bashku do të arrijmë t'ia dalim mbanë, për të arritur standardet e vendeve të zhvilluara evropiane në menaxhimin e burimeve pyjore, për të krijuar një shërbim pyjor eficient dhe profesional.

Extended meeting in the Faculty of the Forestry Sciences, Agricultural University of Tirana



The Minister of Environment, Forest and Water Administration, Mr. Fatmir Mediu, held a discussion with the academic staff of the Faculty of Forestry Sciences in the Agricultural University of Tirana, regarding the initiative expressed by the Prime

Minister Mr. Berisha for the privatization of the forests and their management by the state only at 10 percent.

The meeting was opened by Prof. Dr. Vath Tabaku, decan of the Faculty of Forestry Sciences, who thanked the participant for attending, and evaluated the contribution of the Minister Mediu to give the Faculty an important role in designing strategies for development of Forestry in Albania. He said that the academic staff of this Faculty, will always be willing to collaborate without any reserve, with the only interest to contribute on giving solution to the numerous problems of the Albanian Forestry.

Then the word was taken by Minister Mediu, who express the main direction of the work that Ministry had, in aligning the legislation, harmonized with EU countries and suitable for the conditions of our country (taking as an example Slovenia). The law is drafted and soon, it will be thrown up for discussion with the stakeholders and for public transparency.

During this meeting, the academic staff of the Faculty of Forestry Sciences, as well the representatives from the interested groups, expressed that such initiative, is expected to be highly efficient, bringing an ever-closer relationship between the private and the forest, which at the moment in which they consider it as their property, will show even more attention to management of utilization of space. In this view, the professors of Faculty expressed that they will check the possibility to change the academic curricula, in order that such initiative to be oriented from the first year of education, with all priorities and diversities ...

Page 1



Historically the village has had its boundaries, although it is gradually increased, all the inhabitant remember each other's borders for the forests that they used before 1945. There are 24 designed management plans from USAID and AFFDP and there are defined the user for each plot, as well as 120 management plans from World Bank, where are defined for each village and each plot the traditional users, confirmed with decisions from the village and the commune.

Each one can prove this heritage in a very simple way, although the forests and pastures were not separated by boundaries between villages; although the state had no map or register for the

village or family boundaries, in 1990, anywere it was proved, it was noted that the village commissions with representatives of villagers found and most of them accepted these boundaries, coming back from the canons decided from the villagers.

In 240 new management plans and the revisions of NRDP project has had a separation that if you look it carefully, they neglected the separation of users because of the low payment in the design of plans, than the real situation of traditional users.

If you go to the villages, from Elbasan (Shkumbin river) to Vermosh, most properties have traditional boundaries and no one can enter in the forest of

The forest between tender and real guardian centuries ...

the neighbor to cut the trees or the foliage.

We are always talking about the oak forests near the villages, from which in 1990 had almost remained only the roots...and these are about 400 thousand ha!

The tender is to cut the big trees, to take what you can and to abandon the forest. This is what happened in these 20 last years and it is considered legitimate. Differently from this destructive law, the traditional user and the guardian, live with the forests; they care about the establishment and not burning after cutting. The Ministry these 20 last years develops only the tender of cutting or planting. After that, the seedlings or sprouts that want to grow from the cutting forest, are found without protection, under fires, grazing and destroyed...

The tender should meet the market needs. The sale is 10 times less that the annual cutting. 90% of cutting is spontaneous and the spontaneous cutting, as it is the tender, is not followed by care and increase.

Our Forests are not destroyed by cutting, but because they miss the care and are poorly treated, as in cutting process and after it. The result is below zero, destruction comes as avalanche, because the guardian of the forests is missing. Maybe the state is afraid from the guardian, because he will request to anyone to take care about the forest. For this care and the establishment of the forest we want the guardian. We want the forest to go to the owner and put it under his care ...

Page 1, 5

The fruitful cooperation of private forest owners in Kosovo

Bashkim Gashi, chairman of NAPFO, Kosovo



National Association of Private Forest Owners, in cooperation with the Netherlands Development Organization, SNV, at the end of last December held a meeting with heads of local associations established in regions where SNV operates, and the members of NAPFO leadership. The meeting annual performance report submitted by 14 municipalities associations and NAPFO with a description of activities from the beginning of the process of municipal association, results, and plan for the future ...

Page 2

Consultative workshop, which gives way to a new project



Albora Kacani
NACFP, Tirana

Page 4

Real massacre against wild fauna in the crisp winter days



Page 6

by Themis Perry



Albanian medical plants in the international market

Prof. Dr. Ahmet Osja

Page 7

Dear readers of the newspaper "Green Crown"!

We are in the preparatory phase of drafting a new law for Forests and as a very important moment we ask your support, comments, opinions and suggestions about it.

Feel free to contact us at any time without hesitating.

Contact persons:

Veli Hoxha: Redaktor Pergjegjes velihoxha@yahoo.com

Albora Kacani E-mail: alborakacani@hotmail.com

NJOFTIM

Fidanishtja e Kurtish Dafkut në Komunën TopoJan të Kukësit, disponon fidanë:

- | | |
|--------------------------|-------------|
| 1. Mështekne (dyvjeçarë) | copë 30 000 |
| 2. Pishe (dyvjeçarë) | copë 10 000 |

Për më tepër informacion, kontaktoni:

Kurtish DAFKU cel: 068 62 75 433; 067 20 37 565

KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Shqipëri dhe e Asosacionit të pronarëve Privatë, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha

Kryeredaktor: AHMET OSJA Zv.kryeredaktorë: Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; e-mail: fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org

www.akppp.org

